



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2035 / Prot.

Patos, më 05/09 / 2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 04 SHTATOR 2024

Vendi: "Salla e mbledhjes të Këshillit Bashkiak Patos"

Ora e fillimit : 10:00

Ora e mbarimit : 12:00

Dëgjuesë publike me temë: "Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027"

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 71 datë 30.11.2023 "Mbi strukturën e nivelit të taksave dhe tarifavë vendore për vitin 2024" dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025"

Pjesëmarrës: Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Deputete e Qarkut Fier znj. Antoneta Dhima, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, përfaqësues të subjekteve private të cilët operojnë në territorin e bashkisë Patos dhe rreth 56 pjesëmarrës (banorë dhe Kryetarë të fshatrave dhe përfaqësues të subjekteve që operojnë në territorin e bashkisë Patos).

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj:

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj: - të nderuar të pranishëm, ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025”. Siç e kemi thënë edhe më parë ne kemi një rregull për dëgjesat, gjithsecili para se të kërkoj fjalën duhet të prezantohet me emër, pasi takimi rregjistrohet dhe çdo ankesë, propozim apo mendim i juaj do trajtohet në bazë të ligjeve në fuqi. Edhe njëherë ju falenderoj për pjesëmarrjen. Dëgjesën e deklaroj të hapur, fjala është për ekzekutivin për paraqitjen e materialit për paketën fiskale 2025.



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

***“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”***

Shtator 2024

Specialist i drejtorisë së të Ardhurave Vendore z. Astrit Murati – faleminderit kryetar, më lejoni t’ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ lidhur mbi prezantimin e projekt dokumentit “të Paketës Fiskale 2025” ku është një dokument që prezanton taksat dhe tarifat për një periudhë një vjeçare. Pas prezantimit të paketës do të bëjë një përmbledhje të ndryshimeve të draft dokumentit në krahasim me paketën fiskale që është akoma në fuqi deri në fundin e vitit



**Specialist i drejtorisë së të Ardhurave
Vendore z. Astrit Murati**

Dëgjesë publike me temë:

***Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”***

Shtator 2024

aktual. Astrit Murati - Prezanton paketën fiskale për vitin 2025 si dhe lehtësirat e parashikuara për kategori të caktuara.

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro - përshëndetje të gjithëve! Më lejoni t'ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ për paketën fiskale për vitin 2025, e cila mbështetet në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore". Siç e sqaroj edhe Astriti, ne kemi menduar që për vitin 2025, të paraqesim të njëjtën paketë fiskale, e cila është në fuqi e miratuar me VKB nr. 80, përfshirë edhe disa ndryshime të vogla të cilat janë të përcaktuara nga qeveria. Përsa i përket komunitetit do të mbetet i njëjti nivel taksash dhe detyrimesh dhe përjashtimesh të miratuara në paketën aktuale, ndërsa biznesi është subjekt i ligjit. 9920 dhe do të jenë të njëjtat nivele taksash, tarifash dhe shërbime dhe afati i shlyerjes do të jetë deri në 30 qershor të vitit kalendarik.



**Kryetari i Bashkisë
z. Fation Duro**

Dëgjese publike me temë:

*Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027"*

Shtator 2024

Ne jemi duke parë me grupin e menaxhimit vendosje e tarifave të reja për kryerjen e shërbimeve në shtëpi banimi për qytetarët do të jetë 5 mijë lekë të reja, ndërsa për subjektet në vlerën 10 mijë lekë të reja, por edhe tarifa të tjera të cilat lidhen me marrjen e aseteve të bashkisë. Përsa i takon buxhetit janë dy faktorë që ndikojnë në buxhetin e bashkisë komuniteti dhe biznesi. Ku komuniteti është dhe pjesa më e ndjeshme sepse biznesi është subjekt i ligjit nr. 9920, i cili hyn në shumë filtra shtetërorë. Në paketën fiskale të vitit 2025 tre janë taksat kryesore për komunitetin: 1. Taksa e ndërtesës 2. Taksa e tokës bujqësore dhe 3. Tarifat e shërbimit, e cila përfshin tarifën e pastrimit dhe tarifën e shërbimit komunitar ku sigurisht në bazë të ligjit janë përcaktuar edhe kategoritë përjashtimore nga taksat vendore të cilat Astriti i shpjegoi të detajuara. Gjithsesi jemi në fazën e marrjes së propozimeve tuaja për ndryshime që do të pasqyrohen në draft dokumentin përfundimtar të paketës fiskale e cila do të prezantohet përsëri në komunitet për të kaluar më pas

në miratim nga këshilli bashkiak. Për çdo pyetje komente apo sygjjerime jam i hapur për diskutim, Faleminderit!

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj: - Ju faleminderit për gjithë përshtkrimin e draft dokumentit të paketës fiskale. Fjala është për ju për paraqitjen e propozimeve tuaja se çfarë mund të ndryshojmë në këtë draft dokument.



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

***“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”***

Shtator 2024

Banor i fshati Dukas z. Haxhi Dorti- unë ju falenderoj që na bëni pjesë të këtyre takimeve, lidhur mbi taksat unë nuk kam asnjë kundërshtim pasi ato duhet të paguhen nga të gjithë, por unë doja të merrja pak informacion lidhur mbi rrugën e re që keni bërë. A është marrë në dorëzim nga bashkia pasi nuk kemi informacion dhe personalisht jam taksapagues i rregullt dhe nuk marr asnjë shërbim, nuk bëhet pastrimi. Kemi 30 vjet që nuk marrim si lagje shërbim nga bashkia.



**Banor i fshati Dukas
z. Haxhi Dorti**

Dëgjesë publike me temë:

***“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”***

Shtator 2024

Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro- ajo rrugë ka qenë projekt i cili ka pas filluar disa vite më parë dhe si projekt rruge ka qenë pa sistem ndriçimi, por unë po ju bëj me dije se bashkia ka projektuar disa rrugë të cilat do të kenë sistem ndriçimi dhe rruga e lagjes suaj do të mbyllet brenda këtij muaji.

Banor i qytetit z. Hajdar Rrapaj - po te kjo rrugë që u diskutua nga parafolësi ka edhe një problem tjetër që lidhet me hedhjen e mbeturinave në sheshpushim, bëhet fjalë për inertet të cilat u hodhën aty dhe dikur te ai sheshpushim na ishte premtuar se do të bëhej lulishite dhe vend pushimi për pensionistët. Problem tjetër në lagjen tonë është mungesa e shërbimit të pastrimit dhe punëtorët kryejnë shërbim deri te pallatet dhe më pas nuk bëhet asnjë shërbim pastrimi. Kërkoj që të bëhet pastrimi i inerteve si dhe të vendosen stola.



**Banor i qytetit
z. Hajdar Rrapaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”

Shtator 2024

Banor i lagjes 29 Marsi z. Daut Velaj – kemi një problem lidhur mbi qendrën e qytetit dhe doja të dija nëse ka ndonjë plan rregullues për rregullimin e qendrës së qyteteve? Janë bërë investime në ujësjellës, por pallatet kanë akoma në soletat e tyre depozitat e ujit dhe doja të dija a ka një plan nga bashkia për heqjen e depozitave? Një problem tjetër që doja të ngrija ka të bëjë me pallatin e kulturës kati i parë i tij ku ndodhet ekspozita e fotografive, e cila ka vite që qëndron aty dhe ajo është një pjesë e historisë së qytetit dhe doja të dija a ka një projekt për restaurimin e tyre?



**Banor i lagjes 29 Marsi
z. Daut Velaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”

Shtator 2024

Kryetar i fshatit Rerës z. Saban Ruçaj – më lejoni si fillim t’ju falenderoj në emer të gjithë banorëve të fshatit për rrugët që keni hapur deri tani, por ka edhe pak punë në rrugët e lagjeve

Zeballarët, Gjigji dhe Rrapushaj. Ka disa segmente rrugore të cilat kanë nevojë për ndriçim dhe e mira do të jetë që bashkia të investojë në ndriçimin rrugor me panele diellore. Ujrat e zeza në lagjen Karemanaj kanë nevojë për ndërhyrje.



**Kryetar i fshatit Rerës
z. Saban Ruçaj**

Dëgjesë publike me temë:

*“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve
të projekt dokumentit për hartimin e
Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”*

Shtator 2024

Banore e lagjjes Naftëtari znj. Mimoza Mahmutaj – unë kam një ankesë lidhur mbi një mur, i cili është ndërtuar te pallatet në lagjen “Mustafa Matohiti” duke zënë hapësirën publike. Aty më parë ka qenë një kënd lojrash për fëmijë. Gjithastu te stadiumi qendra e pushimit është dëmtuar ndaj të shikohet mundësia për tu rregulluar.



**Banore e lagjjes Naftëtari
znj. Mimoza Mahmutaj**

Dëgjesë publike me temë:

*“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve
të projekt dokumentit për hartimin e
Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”*

Shtator 2024

Banor i lagjjes “së Re” z. Shpëtim Gjata- në lagjjen time nuk është bërë asnjë ndërhyrje për riparimin e saj dhe nuk shkon më shumë se 150.



**Banor i lagjjes “së Re”
z. Shpëtim Gjata**

Dëgjesë publike me temë:

*“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve
të projekt dokumentit për hartimin e
Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”*

Shtator 2024

Gjithashtu koshat e plehrave janë pa kapak dhe nëse do të krijohet mundësia e zëvendësimit të tyre.

Kryetari i komitetit të Veteranëve LANÇ z. Harun Nazëraj - kërkoj vazhdimin e punimeve për kanalizimin e lagjes. Investimi për pastrimin e përroit është punuar mirë deri tani dhe në të ardhmen shikoni mundësinë që përreth përroit të bëhet shëtitore apo vend shlodhes për të gjithë banorët. Investimi për rehabilitimin e përroit deri tani është punuar mirë dhe në të ardhmen mund të parashikoni të bëni një shëtitore apo një vend shlodhës për të gjithë banorët.



**Kryetari i komitetit të Veteranëve LANÇ
z. Harun Nazëraj**

Dëgjesë publike me temë:

***“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”***

Shtator 2024

Kryetar i fshatit Kuqar z. Islam Shpata - duket qartë që bashkia po punon jo vetëm në qytet, por edhe në fshat, por atë që unë do të kërkoj është përdorimi i rërës bituminoze për shtrimin e rrugëve në fshatra. Vërtet që e mira do të ishte të bëheshin me asfalt, por me rëra bituminoze do të na zgjidhni shumë punë si në rrugët e brendëshme të fshatit, por edhe në rrugët e parcelave.



**Kryetar i fshatit Kuqar
z. Islam Shpata**

Dëgjesë publike me temë:

***“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e Buxhetit
Afatmesëm 2025-2027”***

Shtator 2024

Kryetari i bashkisë z. Fation Duro – faleminderit për çdo kërkesë dhe shqetësim që parashtruat. Kërkesa e parashtruar lidhur mbi rrugën në fshatin Dukas është parashikuar dhe shumë shpejtë do të fillojnë punimet.

Lidhur mbi kërkesën për ndërhyrje në qendrën e qytetit padiskutim që do të ishte një investim i mirë, por është shumë nuk është aq emergjent sa janë ndërhyrjet në lagjet e qytetit dhe për qendrën e qytetit do të shohim mundësinë e ndërhyrjes në sistemin e vaditjes. Lidhur mbi shqetësimin e ngritur lidhur mbi vendosjen e depozitave të ujit në fillim duhet të mbyllet loti i dytë i ujës-jellësit ndaj në këtë moment nuk ndërhyjmë dot për heqjen e depozitave. Problemi i ngritur për pallatin e kulturës për katin e parë, në të vërtetë pallati i kulturës kërkon rikonstruksion total i cili nuk mund të mbulohet nga buxheti i bashkisë ndaj për rikonstruksionin e saj do të drejtohem i Fondit të Zhvillimit. Lidhur mbi ndriçimin rrugor shumë shpejt do të filloj edhe ndiçimi në fshatin Rerës në segmentet të cilat nuk kanë ndriçim. Lidhur mbi problemin te përroi do të bëhet i gjithë rehabilitimi i zonës. Lidhur mbi shqetësimin e ngritur nga zonja në lagjen “Mustafa Matohiti” me punonjësit e agjencisë së shërbimeve kanë filluar punimet për rikonstruksionin e zonave të hapësirave publike ndërsa për shesh pushimin duhet ta shikojmë se çfarë mund të bëjmë. Lidhur mbi koshat e plehrave, dizifektimi i tyre bëhet i tyre bëhet çdo jave. Kërkesa për rrugën e oficinës do të shikohet mundësia për rehabilitimin e këtij segmenti rrugor gjithashtu do të shohim mundësinë për të ndërhyrë së shpejti në lagjen “Naftëtari”, rruga te kalçetoja në krahun e majtë të saj.



**Kryetari i bashkisë
Z. Fation Duro**

Dëgjësë publike me temë:

“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”

Shtator 2024

Lidhur mbi ndryshimet e reja në ligjin e urbanistikës për ndërhyrje dhe kryerje punimesh në banesë apo edhe në subjekte në rang vendi në jemi bashkia që do të aplikojë tarifën më të ultë lidhur mbi marrjen e këtij shërbimi leje për ndërtim çative të pashfrytëzueshme në vlerën 5 mijë lekë, leje e cila kërkon si dokument shoqërues planin e vendosjes në vlerë 10 ose 20 mijë lekë, ndërsa për shërbimin leje për ndërtim të murit rrethues i cili përveç dokumentacionit përkatës do të ketë si dokument shoqërues planin e rievimit dhe ka një tarifë prej 30 mijë lekë do të ofrohet nga bashkia. Planin e vendosjes mund ta bësh edhe në topograf privat edhe me topografin e bashkisë.

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj: - faleminderit Kryetar për të gjithë sqarimin e dhënë. Ndonjë pyetje apo koment tjetër për paketën fiskale 2025? Mqse jo edhe një herë ju falenderoj rëndësinë që i kushtuat këtij takimi, por dhe mendimeve, pyetjeve, sygjerimet e dhëna prej jush. Edhe një herë faleminderit!

Koordinator i Konsultimit Publik

Suzana **Hysenaj**



Sekretar i Këshillit

Refaela **Xeba**



Foto të takimit me temë: “Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2025 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e Buxhetit Afatmesëm 2025-2027”



